




REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVO



KOMUNA E GJILANIT
OPŠTINA GNJILANE
MUNICIPALITY OF GJILAN
GILAN BELEDIYESI

Njësia e Prokurimit

Gjilan me datë: 08.08.2019

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Gjilanit, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit mbi Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 8.1.2) të Rregullës për Parashtrimin e Ankesave të publikuar nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesës për ri-shqyrtim të datës 31.07.2019, të parashtruar nga Operatori Ekonomik **“Eco Higjiëna” Sh.p.k** lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **“Pastrimi i rrugëve, trotuareve, mirëmbajtja e parqeve dhe hapsirave gjebëruese” me Nr. të Prok: GI 651-18-045-2-2-1** nxjerr:

V E N D I M

Refuzohet - kërkesa për ri-shqyrtim e Operatori Ekonomik të **“Eco - Higjiëna” Sh.p.k** të dt. 31.07.2019 lidhur me aktivitetin e prokurimit **“Pastrimi i rrugëve, trotuareve, mirëmbajtja e parqeve dhe hapsirave gjebëruese” me Nr. të Prok: GI 651-18-045-2-2-1** kundër Njoftimit mbi Vendimin e AK për dhënie të kontratës, i datës 26.07.2019 të publikuar në platformën e prokurimit elektronik.

1. **AK vendos të vazhdoj sipas Njoftimi mbi vendimin e AK për dhënie të kontratës të publikuar me datën 26.07.2019.**
2. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronike në adresën : <http://e-prokurimi.rks-gov.net>

A r s y e t i m

Operatori Ekonomik **“Eco - Higjiëna” Sh.p.k** me datë 31.07.2019, ka parashtruar kërkesën për ri-shqyrtim, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **“Pastrimi i rrugëve, trotuareve, mirëmbajtja e parqeve dhe hapsirave gjebëruese” me Nr. të Prok: GI 651-18-045-2-2-1**. Autoriteti Kontraktues me datën **08.08.2019** ka shqyrtuar kërkesën në fjalë si më poshtë:

Autoriteti Kontraktues pas analizimit dhe shqyrtimit të kërkesës tuaj ka konstatuar se të gjitha pretendimet ankimore të cilat janë kontestuar nga ana juaj nuk qëndrojnë pasi që:

Në Njoftimin për Kontratë dhe në dosjen e Tenderit tek kërkesat teknike dhe profesionale janë kërkuar përpos të tjerave edhe

- 1.Cisterna me mekanizim komplet për larjen të rrugeve te jetë me vëllim min 9000L.
- 2.Kamioneta për bartjen e mbeturinave , minimum 2copë.
- 3.Makinë fshirëse speciale për fshirjen e rrugeve dhe trotuarve të qytetit minimum 3 copë.
- 4.Makinë frezë për largimin e borës -1 copë

Ju së bashku me ofertën e juaj nuk keni dorëzuar dëshmi të mjaftueshme siç janë kërkuar në DT dhe në Njoftimin për kontratë.

Gjithashtu, ju njoftojm se në ofertën e juaj, përsëri keni potencuar p.sh në rastë se do të kemi një dimër me shumë borë do të bleni një mjetë të dytë ose do të përdorni forca sezonale.

AK- Komuna e Gjilanit, ju njofton se në DT dhe në Njoftimin për Kontratë kanë qenë të specifikuar qartë kërkesat e AK – dhe dëshmit që janë kërkuar.

Arye tjetër e eliminimit të ofertës tuaj është edhe tejkalimi i vlerës së parashikuar të kontrates nga AK.

Andaj, duke u bazuar në të gjitha dëshmitë që posedon AK- Komuna e Gjilanit i hedh poshtë të gjitha pretendimet ankimore.

Zyrtari Përgjegjës i prokurimit bazuar ne ato që u thane më lart ka vendosur si ne dispozitiv .

Këshilla juridike:

Kundër këtij vendimi, palët e interesuara mund të paraqesin ankesë pranë OSHP-së . Ankesa pranë OSHP-së duhet te dorezohet brenda 10 (dhjete) diteve pas pranimiit te ketij vendimi.

Kopje: Operatorit Ekonomik;
Zyrës së Kryetarit te Komunës;
Te gjitha palëve te interesuara;
Arkivit të Komunës.

U.D. Menaxher i Prokurimit

